



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.07.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

2. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

3. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.

4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Mbledhja fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit e cila shprehet se në rendin e ditës do të merret për shqyrtim një çështje e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për: 1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; 2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; 3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë; 4. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë; 5. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; 6. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec; Më tej gjykatat e apelit të juridiksionit të

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

përgjithshëm: Gjykata e Apelit Durrës; Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Korçë; Gjykata e Apelit Shkodër; Gjykata e Apelit Vlorë; Gjykata e Apelit Tiranë, dhe në fund Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti i çështjes kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i cili është në proces rivlerësimi kalimtar ndërsa është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore, konkretisht: z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Rexhep Karaj dhe Murat Lleshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që është me leje lindje, konkretisht: znj. Nertila Kape, si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj, të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: z. Edvan Veçani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale, gjyqtari Edvan Veçani.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, por gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat janë ezauruar dhe mbetet vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që do të caktohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, që rezultoi z. Edvan Veçani, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që është me leje lindje, konkretisht: znj. Nertila Kape.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 1, penale, Xhevdet Lika.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 4, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: z. Petrit Çomo. Gjithashtu, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët, në vitin 2020, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, në 2 apo më shumë çështje gjyqësore, konkretisht: znj. Vjollca Spahiu, z. Kastriot Gramshi, z. Bedri Qori.

(Në Seksionin Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë bëjnë pjesë këta gjyqtarë: Petrit Çomo; Arben Mickaj; Gerd Hoxha; Kreshnik Omari; Shefkije Demiraj; Ardiana Bera; Bedri Qori; Vjollca Spahiu; Ahmet Metalia; Sokol Pasho dhe Kastriot Gramshi.)

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Arben Micko dhe Sokol Pasho.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Kreshnik Omari dhe Ahmet Metaliaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 7 në lëndë penale dhe 2 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 5.

Për 7 çështjet penale, ato me nr.1-nr.7, për të cilat kërkohen nga 1 gjyqtar, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Për 2 çështjet civile, ato me nr.8 dhe nr.9, për të cilat kërkohen nga 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti, në shortimin e çështjeve penale, kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konkretisht: z. Zihni Shahu. Gjithashtu përjashtohet në shortimin e çështjeve civile kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: z. Markelian Koca. Në shortimin e çështjes civile nr. 9 të përjashtohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: z. Vladimir Skënderi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Enkeleda Kapedani.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Tomor Kullolli.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtari Taulant Tafa.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Enkeleda Kapedani.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Tomor Kullolli.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Taulant Tafa.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Enkeleda Kapedani.

Për çështjen nr. 9, civile, gjyqtarja Dhurata Billo.

Për çështjen nr. 8, civile, gjyqtarja Shpëtime Pitaku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve të jetë të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: z. Arben Dosti, znj. Blerta Çibuku, z. Pëllumb Vehbi. Gjithashtu të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: z. Sokol Pina.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtaret Suela Xhani dhe Enkeleda Doda.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet si dhe të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: z. Sokol Pina si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të mos përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z.

Dritan Hasani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Shkëlzen Liçaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Përmet. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Përmet që mund të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Gjirokastrë (që nuk rezultoi) si dhe të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Përmet, të mos përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë të kësaj gjykatë, konkretisht: z. Dritan Hasani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Pëllumb Vehbi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve ose jo nga shorti, propozohet si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të mos përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z. Erjon Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetare) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, konkretisht: znj. Alma Ahmeti (Zhupa).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Florin Demollari.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Merita Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, konkretisht: znj. Matilda Shalla. Gjithashtu Në përjashtohen gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z.Piro Sota, znj. Igerta Hysi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Olkeda Manellari.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konkretisht: znj. Luljeta Kole. Gjithashtu të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Korçë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z. Besnik Shehu, z. Maksim Qirjazi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Arben Lera dhe Ariola Kristo.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale që kanë karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3. Gjyqtari i caktuar si relator për çështjen nr. 1, nuk mund të caktohet në çështjen nr.2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, që është në proces rivlerësimi kalimtar dhe është njoftuar për seancën dëgjimore, konkretisht: z. Selim Kryeziu si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z. Astrit Kalaja.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Vojsava Osmanaj (relatore), Astrit Kalaja dhe Valbona Vata.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 14 çështje gjyqësore, 4 në lëndë civile dhe 10 në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 14 çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, në varësi të rezultateve të shortit, të jetë jo më pak se 11, nga të cilët 3 nga Gjykata e Apelit Tiranë, 3 nga Gjykata e Apelit Vlorë, 2 nga Gjykata e Apelit Korçë dhe 1 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

1. Për çështjet civile nr. 1 - nr. 4, për të cilat kërkohen nga 1 dhe 3 gjyqtarë, të caktohen 3 gjyqtarë të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku dy nga të cilët të konsiderohen si të përzgjedhur me short nga ata që janë përzgjedhur më herët për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, konkretisht znj. Elona Toro dhe znj. Elbana Lluri. Në këtë rast të përzgjidhet me short gjyqtari i tretë nga ata të Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Për çështje penale nr. 9, nr. 12 dhe nr. 13, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, në secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Për çështje penale nr. 8, nr. 10 dhe nr. 11, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, në secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

4. Për çështje penale nr.6, nr.7 dhe nr. 14, për të cilat kërkohen nga 1 gjyqtar, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë.

5. Për çështje penale nr.5, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: z.

Ridvan Hado, znj. Iliba Bezati dhe znj. Nertina Kosova. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civile të Gjykatës së Apelit Tiranë, si më poshtë: znj. Elona Toro dhe znj. Elbana Lluri, të cilat propozohet të caktohen për gjykimin e tyre; znj. Flutra Skënderi, që është në proces rivlerësimi kalimtar dhe është njoftuar për datën e seancës dëgjimore; znj. Evjeni Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni, të cilët vijnë të jenë me leje afatgjatë nga ish-KLD-ja. Gjithashtu në shortimin çështjes penale nr.8 të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Skënder Damini dhe znj. Margarita Buhali. Po kështu në shortimin e çështjes penale nr. 9 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Sokol Binaj dhe znj. Saida Dollani. Gjithashtu në shortimin e çështjes penale nr. 10 të përjashtohet gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Hysen Saliko dhe z. Sokol Ngresi. Në shortimin e çështjes penale nr. 11 të përjashtohet gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Sokol Ngresi. Në shortimin e çështjes penale nr. 12 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Sokol Binaj dhe znj. Albana Boksi. Në shortimin çështjes penale nr. 13 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z. Sokol Binaj dhe znj. Albana Boksi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtari Artur Kalaja, i cili është në trup gjykues me dy gjyqtarët që shkojnë automatikisht Elona Toro dhe Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Artur Kalaja.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Elona Toro.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Elbana Lluri.

Për çështjet nr. 9, nr. 12 dhe nr. 13 penale, gjyqtari Dhimitër Lara.

Për çështjen nr. 10, penale, gjyqtarja Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 11, penale, gjyqtarja Klodiana Gjyzari.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Mimoza Margjeka.

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtari Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Mimoza Margjeka.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Olsi Xhavella (relator), Mimoza Margjeka dhe Margarita Buhali (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pesëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 8 çështje gjyqësore, 7 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile, çështje të karakterit tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 8 çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 8 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4 nga të cilët 2 nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe 2 nga Gjykata e Apelit Durrës.

1. Për 3 çështje penale, ato nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, në secilën nga ato si të përzgjedhur me short të konsiderohen gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht gjyqtari Shkëlqim Mustafa për çështjet nr. 1 dhe nr. 2, ndërsa gjyqtari Genti Shala për çështjen nr. 3.

2. Për 2 çështje penale, ato nr. 4 dhe nr. 5, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, në secilën nga ato ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë të caktuar sipas pikës 1, pra mes gjyqtarëve Shkëlqim Mustafa dhe Genti Shala.

3. Për 2 çështje penale, ato nr. 6 dhe nr. 7, për të cilat kërkohen nga 2 gjyqtarë, si dhe për çështjen civile nr. 8, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti në shortimin e çështjeve nr. 6, nr. 7 dhe nr. 8, kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z. Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 penale, gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Tritan Hamitaj.

Për çështjen nr. 8, civile, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarët Tritan Hamitaj dhe Valbon Çekrezi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Kërkesat për çështjet nr. 1 dhe nr. 2 nga Gjykata e Apelit Shkodër janë bërë në kushtet kur Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, me vendimet nr.39 dhe nr.40 regjistri, datë 13.07.2020, ka vendosur të konsiderojë dorëheqjen nga gjykimi i këtyre çështjeve përgjigjen e gjyqtarit Aleks Nikolli, dhënë me e-mail datë 02.06.2020 dhe datë 07.07.2020.

Ndërkohë, me shkresën nr. 962 prot., datë 14.07.2020, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër bën me dije se me vendimet nr.958 prot. dhe 959 prot., datë 15.07.2020, ka revokuar dy vendimet nëpërmjet të cilës ka konsideruar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes në përgjigje të gjyqtarit Aleks Nikolli, ndërsa ky i fundit është paraqitur në detyrë dhe vijon normalisht punën.

Për rrjedhojë, nevojat në këto raste të Gjykatës së Apelit Shkodër për caktim gjyqtari nga gjykata të tjera për plotësimin e trupit gjykues nuk ekziston më, sa kohë në këtë gjykatë aktualisht ka gjyqtar për gjykimin e atyre çështjeve gjyqësore. Prandaj,

referuar nenit 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosi: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të: Kërkesës nr. 39 prot., datë 13.07.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër si dhe të kërkesës nr. 40 prot., datë 13.07.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Ndërkohë në lidhje me çështjen nr. 3, Këshilli do duhet të zbatojë vendimin e tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Nertina Kosova.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 u vendos deklarimi i përfunduar pa një vendim përfundimtar.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sokol Binaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeje gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 4.

Për çështjet nr. 1, nr. 2 dhe nr. 4, për të cilat kërkohet nga 1 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në këtë rast, gjyqtari i caktuar relator në çështjen nr.2, nuk mund të caktohet në çështjet nr.1 dhe nr.4.

Për 1 çështje, atë nr. 3, për të cilën kërkohet nga 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, në çështjen nr.3 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, si më poshtë: z. Izet Dushaj, që është caktuar më parë për gjykimin e saj, z. Desart Avdulaj, kryetar në detyrë i kësaj gjykate; si dhe gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë (që rezultoi të ishte z. Valbon Çekrezi dhe z. Tritan Hamitaj. Gjithashtu në shortimin e çështjes nr.4 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: znj. Miranda Andoni dhe znj. Irena Brahimi si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të mos përjashtohet nga shorti kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 2 penale, gjyqtarët Izet Salaj (relator), Dritan Banushi dhe Enton Dhimitri (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Tiranë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Tiranë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3 (2 apeli Shkodër dhe 1 apeli Durrës).

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, si më poshtë: Gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Apelit Durrës (që rezultuan znj. Vojsava Osmanaj, znj. Valbona Vata dhe z. Astrit Kalaja); Gjyqtari Selim Kryeziu, që është në proces rivlerësimi kalimtar dhe është njoftuar për seancën dëgjimore. Po kështu, në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, si më poshtë: Gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë (që rezultoi të ishte zoti Valbon Çekrezi dhe zoti Tritan Hamitaj) dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë (që rezultoi të ishte zonja Anita Mici); Gjyqtari Desart Avdulaj, kryetar në detyrë i kësaj gjykate.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Izet Dushaj (relator), Lindita Hoxha dhe Aleks Nikolli (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore për përjashtim të trupit gjykues.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2. Gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimi

kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, që është në përbërje të trupit gjykues në çështjen e themelit kundër kallëzuesve, ndërkohë që çështjet në shqyrtim lidhen me ankimin e kallëzuesve ndaj vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal të bërë kundër gjyqtarëve të veçantë të përfshirë në gjykimin e çështjes së themelit kundër tyre, konkretisht: z. Artur Kalaja. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, të cilët janë caktuar në shortin e mëparshëm (të datës 09.07.2020) për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatës e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Manjola Xhaxho; znj. Alma Kolgjoka; znj. Ornela Naqellari; znj. Esmeralda Xhili (Çeka); z. Rexhep Bekteshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Ridvan Hado.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për të gjitha gjykatat.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor